



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 7.10.2021

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 7.10.2021, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 303 i Kodit të Procedurës Civile

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit ndaj vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në disa elemente të këtij ankimi, referuar shkaqeve të ankimit dhe provueshmërisë së tyre, që rezultoi në përfundim të hetimit gjyqësor.

1. Nisur nga përmbajtja e hetimit administrativ dhe vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për këtë subjekt rivlerësimi, referuar Rekomandimit të ONM-së të datës 11.11.2020, Komisioneri Publik vlerësoi se kishte nevojë për hetim të mëtejshëm në lidhje me dy çështje të pahetuara gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, më konkretisht: (i) pretendimin se subjekti i rivlerësimit zotëron pasuri të padeklaruara, pretendim ky i ngritur në një denoncim anonim, administruar nga ONM-ja në datën 10.11.2020, si dhe (ii) hetimin e një kontrate të vitit 2015, të emërtuar “kontratë huaje”, referuar Regjistrin të Veprimeve Noteriale të Ministrisë së Drejtësisë.

1.1. Komisioneri Publik çmon të sjellë në vëmendje faktin se Rekomandimi i ONM-së, në rastin konkret, për vendimin nr. 286, datë 4.8.2021, është paraqitur në datën 11.11.2020, në ditën e parafundit të afatit ligjor për ushtrimin e ankimit nga Komisionerët Publikë.

1.2. Komisioneri Publik përgjegjës për çështjen, me raport të arsyetuar, vendosi të mos ushtrojë ankim. Ankimi u ushtroi nga Komisioneri tjetër Publik. Komisioneri Publik që ushtroi ankimin, çmon të sjellë në vëmendje se Rekomandimi i ONM-së në rastin konkret, duke iu referuar si çështje kryesore për të cilën kërkohet hetim i mëtejshëm denoncimit të ardhur, në datën 10.11.2020, pranë ONM-së, ku pretendohet fshehtë e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe një kontrate huaje të pahetuar më parë nga Komisioni.

1.3. Rezultatet e këtij hetimi të ri për këto dy çështje, pasurisë së fshehur dhe kontratës së huas, referuar paragrafit të fundit të faqes 2 të Rekomandimit të ONM-së, mundeshin eventualisht të sillnin, zbatimin e paragrafit 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, duke u konstatuar, në vlerësimin tërësor të çështjes, cenimi i besimit të publikut¹.

1.4. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, çështjet e pasurisë ose të profesionalizmit nuk mund të konsiderohen si shkaqe të cilat, si të vetme, duhet të passillnin zbatimin e dispozitës së nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

1.5. Komisioneri Publik, në hartimin e ankimit, në interpretim dhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerësoi se elementi kryesor që do të mund të sillte një vlerësim qoftë dhe të vetëm, pa pasur nevojë për të thirrur në ndihmë shkaqe të tjera kumulative të lartpërmendura, është fshehja e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, përkatësisht pronësia në aksionet e një shoqërie ndërtimi.

1.6. Fshehja e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, për nga vetë rëndësia, është parashikuar nga kushtetutëbërësi si shkak i tillë, që i vetëm do të passillte zbatimin e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në paragrafin 5 të aneksit të Kushtetutës.

1.7. Ndërkohë, Komisioneri Publik konstaton se gjatë vlerësimit të kriterit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit diferenca negative për vitet 1993-1998 rezulton në shumën - 85.817 lekë², ndërsa për vitet në vazhdim (1999-2016) diferenca negative rezulton në shumën rreth - 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë³.

1.8. Në këto kushte, Komisioneri Publik, referuar edhe përmbajtjes së Rekomandimit të ONM-së, është në mungesë të referimit të vetëm të këtij shkakut, si ekzistencë të kushteve të zbatimit të dispozitës së nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

1.9. I njëjti interpretim ka shërbyer dhe për të konkluduar në lidhje me mangësinë e vërejtur për subjektin e rivlerësimit në aspektin e aftësive profesionale.

2. Në parashtrimet e tij, në seancën e datës 30.9.2021, Komisioneri Publik kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor për shkaqet e ankimit. Kolegji pranoi këtë kërkesë të Komisionerit Publik si të bazuar dhe vendosi riçeljen e hetimit, duke administruar, në cilësinë e provës, aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe administrimin e drejtpërdrejtë të të gjitha të dhënave dhe dokumenteve të regjistruara në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në dosjen elektronike të Shoqërisë tregtare “**** **” sh.p.k., si dhe mos hetimin lidhur me tri denoncimet e depozituara në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

3. Komisioneri Publik, në përfundim të hetimit gjyqësor, vlerëson, në mënyrë analitike, si vijon:

3.1. **Lidhur me hetimin për pasuri të padeklaruar të subjektit të rivlerësimit në Shoqërinë “**** **” sh.p.k.**

3.1.1. **Komisioneri Publik**, në parashtrimet e datës 30.9.2021, kërkoi të administrohen:

¹ Referohuni paragrafit të fundit të faqes 2 të Rekomandimit të ONM-së.

² Shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit për vitet 1993-2000 janë llogaritur në masën 66% të të ardhurave të dokumentuara, dhe jo sikundër ka pretenduar subjekti për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës në një masë më të ulët, çka do të përmbyste rezultatin negativ për këto vite.

³ Më konkretisht për vitet 1999-2000 është analizuar mundësia financiare e subjektit dhe e prindërve të tij për të dhënë hua shumë 500.000 lekë (hua dhënë tezes për blerjen e apartamentit në Shoqërinë “****”), nga ku ka rezultuar një diferencë negative në shumën -111.848 lekë. Blerja përkatëse e vitit 2000 dhe mënyra e deklarimit nga ana e subjektit të rivlerësimit ka qenë pjesë e hetimit të Komisionit, subjektit i është kaluar barra e provës dhe Komisioni ka administruar një sërë aktesh dhe shpjegimesh gjatë hetimit administrativ. Sa i takon analizës financiare për periudhën 2003-2016 rezulton në total për të gjithë periudhën një pamjaftueshmëri në shumën -1.185.901 lekë, përkatësisht në vitet 2007, 2015 dhe 2016 (në ndryshim nga Komisioni, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë llogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it në shumën 235.968 lekë/person në vit, si dhe janë llogaritur ndryshimet e likuiditeteve *cash* bazuar në deklaratimet e kryera në DV-2007 dhe në Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.3.2011).

(i) praktika dokumentare për regjistrimin e Shoqërisë “**** ****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor ***.***, duke iu drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

(ii) Praktika dokumentare për regjistrimin e Shoqërisë “**** ****” sh.p.k, me numër ***, më përfaqësues ligjor ***.***, duke iu drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3.1.2. **Subjekti i rivlerësimit**, ndër të tjera, në parashtrimet e datës 30.9.2021, është shprehur se: [...] ky denoncim është totalisht një trillim dashakeqës... denoncuesi me provat që i ka bashkëlidhur denoncimit, me shpresën se do ta bënte të besueshëm atë, në fakt ka provuar pavërtetësinë e tij. Denoncuesi e ka shoqëruar denoncimin me një foto të godinës së apartamentit ku unë banoj, e cila është një pasuri e hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme nga Komisioni, si dhe me një dokument Ekstrakt Historik të Shoqërisë ndërtimore “**** ****” sh.p.k. Ky dokument zyrtar konfirmon qartë se ky person juridik që në momentin e krijuar deri në momentin e paraqitjes së denoncimit, ka një ortak të vetëm, i cili në asnjë moment dhe në asnjë rrethanë nuk ka transferuar kuota në favor të ndonjë personi tjetër... pavërtetësinë e denoncimit anonim ju mund ta konstatooni lehtësisht nëpërmjet aksesimit të drejtpërdrejt elektronik të të dhënave zyrtare të Regjistrimit Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në lidhje me të dhënat e regjistruara, si dhe historikun e veprimeve të kryera nga Shoqëria “**** ****” sh.p.k.[...]⁴.

3.1.3. **Subjekti i rivlerësimit** i ka kërkuar trupit gjykues sa vijon: [...] për këtë shkak të ankimit i kërkoj trupit gjykues që, mbi bazën e akteve të hetimit administrativ, të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në procesin tim të rivlerësimit, të konstatojë se marrëdhënia e vetme që unë kam me Shoqërinë “**** ****” sh.p.k., sikurse është provuar tashmë, është një marrëdhënie kontraktore në përputhje të plotë me ligjin dhe detyrën e gjyqtarit, si dhe, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin...” , nëpërmjet aksesit të drejtpërdrejt elektronik në të dhënat zyrtare të Regjistrimit Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, të konstatojë se denoncimi anonim që pretendon se unë jam ortak me 15% të aksioneve në Shoqërinë “**** ****” sh.p.k. është vetëm një trillim dezinformues [...].⁵

3.1.4. **Kolegji**, me vendim të ndërmjetëm, të shpallur në seancën gjyqësore të datës 30.9.2021, vendosi administrimin e aktit “Ekstrakt Historik”, si dhe aksesimin dhe administrimin e drejtpërdrejtë të të gjitha të dhënave dhe dokumenteve të regjistruara në Regjistrimin Tregtar të QKB-së, në dosjen elektronike të Shoqërisë tregtare “**** ****” sh.p.k.

3.2. Lidhur me hetimin për kontratën e huas të vitit 2015, pasqyruar në regjistrin noterial, administruar nga Ministria e Drejtësisë

3.2.1. **Komisioneri Publik**, në parashtrimet e datës 30.9.2021, lidhur me këtë shkak ankimi, ka kërkuar të administrohet praktika dokumentare për aktin noterial nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.5.2015, ku njëra palë është z. Genti Shala, duke iu drejtuar noterës ***.***.

3.2.2. **Subjekti i rivlerësimit**, lidhur me këtë shkak ankimi, ndër të tjera, në parashtrimet e datës 30.9.2021, është shprehur se: [...]...ju sqaroj se akti noterial, të cilit ky ankim i referohet si “kontratë huaje” është në fakt “një kontratë huapërdorje pasurie të luajtshme automjet”, me qëllim përdorimin nga ana ime me cilësinë e huapërdorësit të një automjeti, objekt i kësaj kontrate, në pronësi të huadhënësit ***.***. Fakti që në shkresën e sipërcituar të Ministrisë së Drejtësisë ky akt noterial është paraqitur si kontratë huaje, vlerësoj se ka ardhur si pasojë e një gabimi teknik, që ka të bëjë me formatimin e informacionit të përcjellë nga Regjistri Elektronik i Noterëve... Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate noteriale, një kopjo të së cilës unë e disponoj dhe e depozitoj... Duke kërkuar që të merret në cilësinë e provës në këtë gjykim, huadhënësi deklaroi se automjetin e tij ma jep mua në përdorim (në cilësinë e huapërdorësit), për një periudhë 10 (dhjetë) ditore, që nga data **.8.2015, për ta përdorur brenda dhe jashtë territorit shqiptar. Ky akt noterial u hartua me qëllim përdorimin e automjetit nga ana ime për një udhëtim që kisha planifikuar së bashku me familjen time, për në ***, Greqi, në vitin 2015... Këtë udhëtim e kam

⁴ Faqe 2 e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 30.9.2021.

⁵ Faqe 4 e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 30.9.2021.

deklaruar gjatë hetimit administrativ, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, dhe të gjitha elementët e këtij udhëtimi i janë nënshtruar hetimit administrativ, pasi ai është i pasqyruar edhe në sistemin TIMS [...].⁶

3.2.3. **Subjekti i rivlerësimit** i ka kërkuar trupit gjykues sa vijon: [...] për këtë shkak të ankimit i kërkoj trupit gjykues që të marrë në cilësinë e provës kontratën noteriale me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.8.2015, të noteres ***.***, dhe të konstatojë se ajo nuk ka asnjë efekt financiar që mund të ndryshojë analizën financiare, që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka bërë për vitin 2015[...].⁷

3.2.4. **Kolegji**, me vendim të ndërmjetëm, të shpallur në seancën gjyqësore të datës 30.9.2021, vendosi administrimin e aktit noterial me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.8.2015, të noteres ***.***.

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

4. Komisioneri Publik detyrohet që kërkimet e tij procedurale në procesin e rivlerësimit t'i bazojë në provat dhe faktet, që administrohen gjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe hetimit gjyqësor të Kolegjit.

5. Nisur nga ky detyrim, Komisioneri Publik konstaton se aktet e administruara nga ky trup gjykues lejojnë të arrihet në përfundime mbi verifikimin e situatës juridike të pahetuar, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie, si dhe llojin e marrëdhënies juridike të pasqyruar kontratës së huas të vitit 2015, në të cilën rezulton palë subjekti i rivlerësimit.

5.1. Komisioneri Publik konstaton se, nga shqyrtimi i *Ekstraktit Historik* të Shoqërisë “**** ****” sh.p.k., i datës **.9.2021, administruar si provë gjatë gjykimit, rezulton që subjekti i rivlerësimit s'është ortak i kësaj shoqërie apo të ketë pasur në zotërim kuota nga kapitali i kësaj shoqërie, si rrjedhim pretendimi për pasuri të fshehur, në formën e pronësisë së aksioneve, në emër të subjektit të rivlerësimit, rezulton i pambështetur në prova.

5.2. Komisioneri Publik konstaton se akti noterial i datës **.5.2015, me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., është me objekt huapërdorje automjeti, me palë huapërdorëse subjektin e rivlerësimit, për rrjedhojë, ky akt nuk ndikon në analizën financiare të vitit 2015.

6. Përfundimisht, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 65, nenit 66, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkon lënien në fuqi të vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Genti Shala.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

⁶ Faqe 4 dhe 5 e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 30.9.2021.

⁷ Faqe 5 e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 30.9.2021.